



REPUBIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr 06-3540 /2023

Klinë, 31.01.2023

## PROCESVERBAL

I Mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 09.12. 2022, , filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Të pranishëm në mbledhje janë: Kryetari i Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, drejtorët e drejtorive, nënkryetarja, znj. Marqe Selmanaj, përfaqësuesi i Policisë së Klinës, përfaqësues të OSBE, Mediave lokale, etj.

Të pranishëm në këtë seancë të jashtëzakonshme të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, nënkryetarja znj. Marqe Tanushi-Selmanaj, drejtorë të drejtorive , media lokale etj.

Mbledhjen e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi. Z. Gashi përshëndeti kryetarin e komunës , nënkryetaren dhe gjithë të pranishmit në sallë. Z. Gashi gjithashtu citoi nenin dhe udhëzimet administrative në bazë të të cilave thirret seanca e jashtëzakonshme. Këtë seancë e akne thirrur 1/3 e anëtarëve të kuvendit të cilët edhe e kanë përcaktuar rendin e ditës. Një pikë të rendit të ditës që është: Informatë rreth gjendjes në zonat e përmbytura nga vërshimet e rreshjeve të fundit të muajit nëntor 2022.

Fillimisht fjalën do at merr drejtori i drejtorisë së shërbimeve publike dhe emergjente, z. Qendrim Millaku për të prezantuar një rezymë për gjendjen në fjalë. Gjithashtu paraprakisht është shpërndarë një raport për situatën e krijuar nga reshjet.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Po mundohem në pika të shkurta që të prezantoj një raport detaj që e kemi pasur me datë 20 dhe 21 nëntor. Me datë 18 nëntor kemi marruar informacion nga instituti meteorologjik i Kosovës që do të kemi të reshura në Territorin e Komunës sonë. Posa e kemi marrë këtë informacion kemi bërë gati dhe kemi qenë në gjendje gatishmërie. Bashkë me kryetarin e Komunës kemi qenë në teren orë pas ore duke vëzhguar rritjen e lumenjve dhe deri në ditët e djeshme me 20 nëntor gjendja ka qenë normale por pas orës 12 është vërejt një rritje e ujit në lumenjtë në Komunë. Po ashtu pas orës 16 dhe 17 intensiteti i ujit ka nisë të rritet. Në orën 17 kemi vizituar bashkë me kryetarin e Komunës bizneset që gjenden në Volljak, Pastaj kemi vazhduar në fshatrat Pogragjë, Dush, Ujmir, Krushevë e madhe, Krushevë e Vogël, Rudicë, Budisalc dhe në Dugujevë

ku edhe kemi mbyllur urën për qarkullim në orën 19:20 bashkë me Policinë e Klinës, si dhe rrugën për në Rudicë. Pas orës 20 gjendja është rënduar dukshëm. Uji ka nisë të hyjë Brenda objekteve, shtëpi banimi dhe bizneseve që gjenden përkaj lumenjve. Po veçoj disa nga këto biznese : Gjitha bizneset që gjenden përkaj lumenjve në Volljak, në Grabanicë në lagjen "Sejdiu", tek "Ura e Haxhisë", Fshatin Ujmir tek lagja "Mustafa", Shtaricë, Dush, Jagodë, Budisalc, Krushevë e madhe dhe Krushevë e vogël, Rudicë. Po ashtu së bashku me kryetarin dhe një pjesë të ekzekutivit kemi qenë në teren deri në orët e para të mëngjesit të së Hënës ku dhe nga afër kemi përcjellë çdo situatë. Falënderoj publikisht kompanitë që na kanë ndihmuar me mjetet e tyre atë natë: Mirusha kompani, Gurëbardhi, Mendi dhe Ajet Foniqi me mjetin e tij privat. Një falënderim të veçantë e kam edhe për stacionin e policisë në Klinë si dhe zjarrfikësit e Klinës të cilët kanë qenë me staf të plotë dhe në gatishmëri ëpr të ndihmuar qytetarët. Njësia ka intervenuar në 14 raste në Komunën e Klinës. Natyra e intervenimit ka qenë evakuimi i njerëzve nga vendet e rrezikshme, shpëtimi i bagëtive , tërheqja e ujit nga bodrumet dhe tërheqja e automjeteve nga zonat e rrezikuara nga uji. Edhe ditën e hënë që nga ora 7 së bashku me kryetarin , nënkryetaren dhe komandantin e policisë kemi monitoruar gjendjen në teren. Ndërkohë kryetari i komunës ka formuar komisionin për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në Komunën tonë. Komisioni në fjalë ka dalë në teren pas kërkesave të qytetarëve drejtuar drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë dhe ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e tyre. Ka bërë edhe vlerësimin e dëmeve edhe në ato vende ku qytetarët nuk kanë pasur mundësi të bëjnë kërkesa. Në total numri i kërkesave të ndryshme nga qytetarët ka qenë 79. Raporti i komisionit përbënë të dhëna të hollësishme për secilin person që ka pësuar dëme nga këto vërshime. Të përfunduar keni edhe raportin final të komisionit i cili komision ka bërë një punë jashtëzakonisht të mirë dhe intensive për çka edhe i falënderoj shumë. Vlera totale e dëmeve është 788 mijë e 663 euro. 500 mijë euro është vlera e dëmeve tek ura në Dugujevë dhe Rudicë ndërsa pjesa tjetër janë dëme në amvisëri , ekonomi familjare dhe infrastrukturë publike. Që gjendja nuk ka qenë më e rëndë dhe dëmet nuk kanë qenë më të mëdha se sa për këto një meritë e ka edhe kryetari i Komunës që vazhdimisht ka investuar në rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe pastrimin e tyre. Ju faleminderit të gjithëve.

Kryesuesi pas raportimit të drejtorit. Z. Millaku, hap debat.

z. Zafer Gashi: Përshëndetje për të gjithë. Kjo seancë e jashtëzakonshme është shumë e qëlluar. E shohim që ka ardhur një raport që është shumë i mirë dhe i shpejt. Konsideroj që është mirë që të planifikohen këto raste ngase nuk është hera e parë që në 2918 Klina ka pasur vërshime që d.m.th. shumë pak jeni marrur me preventivë. Ne i kemi vizituar disa vende dhe kemi parë që kanalet e ujitjes janë të ndërtuara jo me standarde të duhura. Këto kanale ujitjeje do të ndihmonin shumë në këto situata. Pyetja ime do të ishte, këta pronar të bizneseve të dëmtuar a do të duhej të lajmërohen vet këtu në komunë apo ju keni bërë vet vlerësimin ku keni pasur në biznese të dëmtuara ? Them këtë sepse autoservisi me pronarin Mahir Gashin ka pasur vërshime dhe dëme të mëdha , e kam pyetur mbrëmë dhe ai më ka thënë që herën e kaluar keni shkuar vet nuk ka pas nevojë me lajmëruar rastin ndërsa tani nuk e shoh që është në listë. Në të ardhmen do të duhet të kemi investime në preventivë, të ndajmë buxhet për punë cilësore rreth ndërtimit të kanaleve të ujitjes etj. Unë e kam parë angazhimin tuaj, vizitat që i keni bërë por sa keni qenë efektiv , sa familjeve ju keni dërguar ujë të pijshëm në këtë fatkeqësi natyrore? Ndarja e mjeteve për këtë kategori të dëmtuarish është shumë me vend dhe të bëhet sa më parë.

z. Esat Raci: Përshëndetje të gjithëve. Ju përgëzoj për punën e mirë të komisionit për raportin dhe e shoh që ka bërë një punë të mirë. Po ashtu edhe drejtorin e shërbimeve publike e falënderoj për

raportimin por më duket që e la mangu pa falënderuar ish pushtetin e kaluar atë të PDK-së që ka investuar në rregullimin e shtratit të lumit duke e evituar vërshimin e qytetit të Klinës. Fatkeqësitë natyrore ndodhin, askush nuk und ti ndaloj por preventiva që të kemi sa më pak dëme do të duhej të merrej. P.sh në Fshatin Shtaricë është kërkesë e jona që të intervenohet tek ura ose devijimin e lumit që është në mes të fshatit.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje të gjithëve. Kam disa pyetje për ekzekutivin. Pyetja e parë lidhet me shqetësimin që ngritën parafolësit. Pyetja, a ndihmon qeveria kur ka përmbyetje në vendbanime të komunës sonë? A ka ofruar diçka të tillë qeveria deri me tani ndonjë gjë. Po ashtu a ka planifikuar komuna që në të ardhmen të lehtësohen dëmet nga këto vërshime. Në raport e shoh që nuk është evidentuar në detaje se çka është dëmtuar nëpër familje dhe biznese nga këto vërshime.

z. Valmir Bacaj: Përshëndetje të gjithëve. Klina gjeografikisht e ka [pozitën e tillë që gjithmonë rrezikohet nga vërshimet pasi që Klina ka pesë lumenj. Falë investimeve të qeverisë Elezaj në rregullimin e shtratit të lumenjve tani kemi më pak dëme. Konkretisht në fshatin Zajm vitet e kaluar ka pasur shumë më shumë dëme. Të nderuar, ne sot do të votojmë raportin e Komisionit por edhe ndarjen e shumës për ndihmë. Më intereson të di edhe se a ka pasur vizita nga niveli qendror dhe a planifikon qeveria të ndihmoj Komunës së Klinës në këso rastesh.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje për të gjithë. Ato ditë y pa që ishte një fatykeqsi natyrore me dëme shumë të mëdha por sikur mos të kishte intervenuar kryetari i Komunës por edhe ish qeveria e më hershme, dëmet do të ishin më të mëdha. Dua të falënderoj kryetarin e Komunës dhe drejtorin e shërbimeve publike që atë natë në orën 3 të mengjesit kanë vizituar fshatin Zajm. Apeloj tek qeveria që të bëjë një projekt të mirë që të kemi sa më pak dëme nga vërshimet në të ardhmen. Pa një projekt nga qeveria është e pa mundur që të rregullohet në tërësi shtrati i Lumit Drini i Bardhë.

z. Enver Gashi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Gjatë reshjeve gjendja ishte e rëndë në qytet dhe disa fshatra. Po ashtu dëmet ishin të mëdha edhe në ekonominë familjare, toka të mbjella më grurë. Sidomos me këtë problematikë përballen restorantet që janë në breg të lumit. Apeloj tek komuna dhe qeveria që të dëmtuarve të ju dilet ndihmë.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Dua që ta informoj Zafer Gashin për pyetjen që bëri. Të dëmtuarit duhet të vijnë dhe të lajmërojnë rastin në Komunë dhe kërkesa për ndihma në ushqim dhe ujë të pijshëm përveç një rasti të cilit i jemi përgjigjur nuk kemi pasur të tjera raste. Klinën e ka vizituar vetëm drejtori i menaxhimit të emergjencave askush tjetër jo nga niveli qendror.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përshëndetje të gjithëve. Është një seancë e mirë shumë. Dua të ju informoj se komisioni ka bërë një punë të mirë dhe të madhe por nëse ka nevojë ky komision do të dalë prap në teren dhe të bëjë një raport plotësues. Kemi qenë vazhdimisht në kontakt me nivelin qendror por fatmirësisht nuk ka pasur nevojë për ndërhyrje tjetër. Të gjitha pasojat e këtyre vërshimeve do të jenë edhe një mësim për ne në orientimin e investimeve në të ardhmen edhe pse është investuar vazhdimisht prej pas luftës në rregullimin e shtretërve të lumenjve. Unë e falënderoj komisionin që ka bërë një raport gjithëpërfshirës dhe është koha e duhur që ta miratojmë këtë raport. Ekzekutivi do të ju propozoj një shumë për një ndihmë të menjëhershme por paraprakisht duhet miratuar raporti dhe e kemi edhe ditën e hënë që të bëjmë zotim të mjeleve. Vlera është diku tek 80 mijë euro dhe komuna në mënyrë lineare diku 25 % apo aq sa do të përcaktohet do të i ndihmoj të dëmtuarit. Falënderoj edhe nivelin qendror atë që e përmendi edhe drejtori i Shërbimeve Publike me të cilët kemi qenë të

koordinuar mirë për ndihmë eventuale. Investimet që kemi bërë deri me tani kanë qenë të qëlluara por si duket nuk kanë mjaftuar pasi që përsëri kemi dëme të mëdha. Qeveria pasi që të jua dorëzojmë raportin janë zotuar që do të ndajnë mjete shtesë për mbulimin e këtyre dëmeve. Për të ardhmen, kemi projekte edhe për fshatin Ujmir dhe projekte të tjera që do të jenë përkushtimi ynë që të i realizojmë dhe të evitojmë dëme të tilla në raste të tjera.

Znj. Marigona Racaj: Përshëndetje. Gjatë shqyrtimit të këtij raporti po shihet që Fshati Siqevë nuk është përfshirë, Edhe pse është ngritur zëri edhe më parë. Mendoj që duhet të merret parasysh.

z. Kolë Prenaj: Përshëndetje. Me të vërtete raporti është gjithëpërfshirës. Reshjet atmosferike kanë një ndër më të mëdhatë që kanë ekzistuar ndonjëherë. Klinë është një pikë e shkarkimit të ujërave. E përgëzoj drejtorin e shërbimeve publike për intervenimin e mirë dhe me kohë. E falënderoj edhe kryetarin për planifikimet për të ardhmen që posa i përmendi. Drinit të bardhë nuk ju ka kushtuar asnjëherë rëndësi ndërsa probleme me vërshime gjithmonë kanë ardhur më së shumti nga ky lum. Do të duhej që të organizohemi dhe të kontribuojmë të gjithë edhe biznesmenët që kanë bizneset e rrezikuara nga vërshimet, që në të ardhmen ta përballojmë më lehtë. Ndoshta të organizohet një konferencë dhe të përgatitet një projekt se çfarë mund të behët për Komunën e Klinës sa i përket problemeve me të reshura atmosferike dhe vërshimet.

z. Armend Beqiri: Përshëndetje për të gjithë. Nuk mund ta kaloj këtë seancë pa e përmendur dhe falënderuar kryetarin për investimet që janë bërë në shtratin e lumit Lumbardhë. Në fshatin e Grabanicës ka pasur punime një natë para se të kemi vërshime, kjo dhe investimet e tjera gjatë vërës në shtratin e lumit kanë bërë që sot të kemi më pak dëme se sa do të kishim. Sikur të mos kishte pasur investime gjithashtu edhe kanalet e ujitjes në Grabanicë do të ishin jashtë funksionit.

z. Valmir Bacaj: Para se ta votojmë raportin e komisionit kam një kërkesë nga komisioni që nëse ka mundësi ligjrisht të pritët deri të hënën autoservisi që u përmend më herët dhe të përfshihet në këtë raport.

z. Esat Raci: Atë që posa e tha edhe kryesuesi, të mos kufizohemi vetëm tek autoservisi në fjalë por të ju japim mundësi edhe rasteve të tjera që deri të hënën të përfshihen në raport.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Neve nuk na ndalon asgjë që të dëmtuarit të kompensohen edhe me mundësi të tjera jashtë këtij raporti. Qeverisë do të i shkojë raporti ynë por ne do ta njoftojmë qeverinë me mundësitë tona buxhetore dhe vendimin tonë që do të marrim sot. Mundësinë nuk do ta ndalim që të ju ndihmojmë por me udhëzim administrativ afati ka qenë 8 ditor dhe kemi mundësi vetëm deri të hënën që të bëjmë zotime të mjeteve. Kemi edhe rastin e "Central Park" i cili është 50% në territorin e Malishevës por që biznesin e ka të regjistruar në Klinë do të doja që të kemi edhe interpretimin e zyrës ligjore për këtë.

z. Driton Raci, zyra ligjore: Mendoj që mandati i kryetarit të Komunës është brenda territorit të Klinës dhe në këtë rast komuna të i përgjigjet me aq % sa është në territorin e Komunës biznesit në fjalë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Nuk ma merr mendja që kemi pengesë që të i ndihmojmë në dëme nga vërshimet biznesit që është i regjistruar në Komunën e Klinës dhe e paguan tatimin në komunë të Klinës.

z. Tunë Dedaj: nëse biznesi në fjalë i paguan tatimet në Klinë atij i takon kompensimi.

z. Enver Berisha, drejtor i Financave: Përshëndetje të gjithëve. Realisht hapi i parë është bërë i mirë, kjo seancë po e mundëson që komuna të jetë transparente me atë që ka ndodhë. Një punë e një komisioni shumë e shpejt dhe e saktë. Ne kemi bërë vlerësim në kohë dhe të saktë dhe po ofrojmë mundësitë e tona si komunë për dëmet e krijuara. Fatbardhësisht nuk kemi dëme në njerëz. Tani jemi në fund të shpenzimit të mjeteve dhe këto mjete janë që kanë mbetur të lira. Të kishim më shumë do të kishim edhe ndihmë më të mëdha. Unë besoj se edhe nga niveli qendror do të kemi përkrahje. Sa i përket Restorantit "central park", ai edhe biznesin e ka të regjistruar në komunën tonë edhe taksat i paguan në komunën tonë por edhe shumicën e territorit e ka në komunën tonë.

z. Enver Gashi: Është mirë që të bëhet përpjekje qysh tha edhe kryetari dhe të shikohet zona kadastrale rreth këtij rasti.

z. Fadil Gashi, kryesues: besoj që kemi ardhur në fund të këtij debati. Në raport janë përfshirë të gjitha amvisëritë e dëmtuara, ekonomitë familjare dhe bizneset. Duhet atëherë që aty ku ka pas më shumë aty është dëmtuar më shumë prandaj mos ju referoni vlerave për kompensim. Po marrim vendim bashkë me "central park" nëse komisioni gjënë të tjera arsye është punë e tij të përfshihet ose jo. Pas të hënës nuk mund të zotojmë më mjete prandaj mos të mbesin peng të tjerat për dy tre raste për të cilat mund të nxjerrim vendim të veçantë në seanca të tjera. Tani do të votojmë edhe raportin por edhe shumën e ndarjes së mjeteve.

Raporti i komisionit u votua me 25 vota për, Asnjë kundër dhe asnjë abstenim,

Shuma prej 86000 euro sipas ndarjes lineare dhe raportit u votua me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Fadil Gashi